

# GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

## SEKSIONI I TRETË VENDIM

Kërkesa nr. 9096/11  
Vasiliqi Papa  
kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 17 tetor 2024 si një Komitet i përbërë nga:

Peeter Roosma, *kryetar*,

Andreas Zünd, *gjyqtarë*,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*,

dhe Viktorriya Maradudina, *zëvendëssekretare e përkohshme e Seksionit*,  
duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 9096/11) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) më 8 Shkurt 2011 nga një shtetase, greke, znj. Vasiliqi Papa (kërkuesja), lindur në vitin 1926 dhe me banim në Athinë. Ajo u përfaqësua në Gjykatë nga S. Neely i Norton Rose Fulbright, avokatë që e ushtrojnë ligjin në Londër;

vendimin për të njoftuar mbi kërkesën qeverinë shqiptare (“Qeveria”), përfaqësuar nga Agjencia e saj e asaj periudhe znj. A Hicka dhe në vijim nga z. O Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit;

faktin se Qeveria greke nuk kërkoi ushtrimin e së drejtës së tyre për të ndërhyrë (neni 36 § 1 i Konventës dhe Rregulli 44 § 1 i Rregullores së Gjykatës);

vërejtjet e palëve;

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

### FAKTET DHE PROCEDURA

1. Çështja ka të bëjë me pretendimin për mosekzekutimin e vendimeve të brendshme në favor të kërkuesit.

#### A. Vendimet fillestare

1. *Procedurat në lidhje me titullin ndaj tokës: vendimi i vitit 2006*

2. Në një datë të paspecifikuar, kërkuesja i kërkoi Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Vlorë rikthimin e sipërfaqes së saj të tokës në Sarandë (Ksamil), që i ishte shpronësuar gjyshit të saj gjatë periudhës së komunizmit.

3. Më 31 korrik 2006, Komisioni pranoi kërkesën për rikthimin e tokës së kërkueses (“Vendimi i vitit 2006”). Ai konstatoi se gjyshi i ankueses e kishte blerë tokën nga një shitës në vitin 1933.

4. Gjatë përshkrimit të sipërfaqes së tokës që do t’i kthehej kërkueses, Komisioni theksoi se kjo sipërfaqe përbëhej nga një pyll (15.8 hektarë) dhe një kullotë (43.4 hektarë) me një sipërfaqe në total prej 59.13 hektarësh. Sipërfaqja e tokës kishte si kufizime të përgjithshme lumin Dajlan në lindje dhe veri, kullotat e Manastirit të Shën Gjergjit në jug dhe detin në perëndim.

5. Një shënim me shkrim dore për vendimin e vitit 2006 deklaronte se vendimi bëhej i formës së prerë më 25 shtator 2006. Më 20 nëntor 2006, Komisioni konfirmoi se nuk ishte depozituar asnjë ankesë ndaj tij.

6. Më 3 shtator 2007, Zyra e Regjistrimit të Pronave të Paluajtshme (ZRPP) regjistroi titullin e pronësisë ndaj sipërfaqes së tokës në regjistrin e tokave dhe lëshoi vërtetimin nga dokumenti hipotekar

mbështetur në vendimin e vitit 2006. Ajo theksonte se ky regjistrim nuk shoqërohej me një hartë, sepse toka gjendej në një zonë që nuk shoqërohet me hartë treguese për arsye se ndodhet në zonë të paazhurnuar.

7. Më 9 qershor 2008, Agjencia për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronave (“Agjencia”) pasardhëse e Komisionit, informoi kërkuesen se duke qenë se kufijtë e Tokës nuk ishin caktuar në vendimin e vitit 2006, këshillohej që çështja të paraqitej në gjykatë.

#### 2. Procedurat për kufijtë e tokës: vendimi i vitit 2008

8. Në një datë të papërcaktuar, kërkuesja depozitoi një padi në gjykatë në mbështetje të nenit 388 të Kodit të procedurës Civile për “vërtetimin e një fakti për të cilin të dhënat dokumentare ishin zhdukur”. Gjithashtu, ajo kërkoi që të caktohej një ekspert për vendosjen e kufijve të tokës dhe për të “vërtetuar faktin” se cilat ishin kufijtë e tokës. Agjencia e Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave Sarandë, e bashkëpërfaqësuar nga Zyra e Avokatit të Shtetit u citua si palë e tretë në çështjen që nuk kishte të paditur.

9. Pas një raporti nga një ekspert i caktuar nga gjykata, dhe duke pasur në konsideratë parashtrimet e palëve të treta se e kishin lënë çështjen në diskrecionin e gjykatës, më 31 korrik 2008, Gjykata e Rrethit Sarandë lëshoi një vendim me anë të së cilit vendoseshin kufijtë e tokës (“vendimi i vitit 2008”).

#### 3. Procedurat për ekzekutim

10. Më 13 tetor 2008, Gjykata e Rrethit Sarandë lëshoi një urdhër ekzekutimi për vendimet e vitit 2006 dhe 2008.

11. Më 5 nëntor 2008, përmbarimi urdhëroi ZRPP të regjistronte vendimet në regjistrin e tokës.

12. Dy javë më vonë, ZRPP theksoi se vendimi i vitit 2006 tashmë ishte regjistruar në regjistrin.

13. Në lidhje me vendimin e vitit 2008, i cili “vërtetonte nja fakt”, ZRPP-ja refuzoi ta regjistronte atë me arsyetimin se neni 193 § 2 i Kodit Civil parashikonte, se: “vërtetimi gjyqësor i faktit të pronësisë nuk regjistrohet”.

14. Më 5 janar 2009, përmbaruesi gjobiti drejtorin e ZRPP Sarandë, sepse ai kishte penguar procedurat e ekzekutimit.

#### B. Procedurat e anulimit

15. Më 6 Shkurt 2012, Këshilli i Ministrave dhe Avokati i Shtetit kundërshtuan përpara gjykatës dymbëdhjetë vendimet e komisioneve për rikthimin e pronës në lidhje me zonën e Ksamilit, duke përfshirë vendimin e vitit 2006. Përmbaruesit argumentuan se sipas të dhënave të vjetra kadastrale, zona e Ksamilit zotërohej bashkërisht nga një sërë pronarësh, duke përfshirë Shtetin, dhe se komisionet e pronës nuk kishin të drejtë ta ndanin tokën dhe t'i rikthenin seksione specifike ish-pronarëve.

16. Më 9 qershor 2015, kërkuesja ndërroi jetë.

17. Më 7 qershor 2019, Gjykata e Rrethit Sarandë rrëzoi padinë kundër vendimit të vitit 2006 si të pabazuar.

18. Më 5 dhjetor 2022, Gjykata e Apelit Gjirokastrë e rrëzoi vendimin e gjykatës dhe la në fuqi kërkesën e autoriteteve në lidhje me zotërimin *ab indivisio* të tokës. Gjithashtu, gjykata konstatoi se personi i cili kishte shitur *ab indivisio* pjesën e tij të tokës tek gjyshi i kërkueses, faktikisht kishte zotëruar një pjesë më të vogël krahasuar me pjesën që ai kishte shitur (shih paragrafin 3 më sipër). Së fundmi, ajo konstatoi se në vitin 2003 komisioni i pronës kishte lëshuar një vendim tjetër për rikthimin e së njëjtës sipërfaqe toke te trashëgimtarët e personit që ia kishte shitur tokën gjyshit të kërkueses. Në këto rrethana, gjykata anuloi titullin e pronës së kërkueses dhe urdhëroi Agjencinë Kadastrale (pasardhëse e ZRPP-së) që të fshinte nga regjistri i tokës hyrjen në lidhje me vendimin e vitit 2006, që ishte pushuar. Gjithashtu, gjykata vëren se vendimi i saj mbi meritat ishte i zbatueshëm dhe në këtë mënyrë kërkesa e paditësve për një masë të përkohshme për ruajtjen e statusit të pronësisë së pasurive të diskutuara ishte i pavlefshëm.

19. Më 23 shkurt 2023, trashëgimtarët e kërkueses paraqitën një apelim pranë Gjykatës së lartë ku çështja vijon të jetë pezull.

#### LIGJI

##### **A. Qëndrimi i trashëgimtarëve**

20. Më 17 korrik 2015 dhe 7 qershor 2016, trashëgimtarët e kërkueses, z. Michail Angelos Pappas dhe znj. Evrydiki Prapopoulou (Papa), shprehën dëshirën e tyre për të ndjekur procedurat në emër të saj.

21. Gjykata pranon se z. Michail Angelos Pappas dhe znj. Evrydiki Prapopoulou (Papa) kanë interes legjitim në ndjekjen e kërkesës në vend të kërkueses së ndjerë. Për arsye praktike, znj. Vasiliqi Papa do të referohet si kërkuësja (shih *Isayeva kundër Azerbajxhanit*, nr. 36229/11, § 62, 25 qershor 2015).

##### **B. Pretendimi për shkelje të nenit 6 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 për mosekzekutimin e vendimeve të vitit 2006 dhe 2008**

22. Kërkuësja u ankua se vendimet e vitit 2006 dhe 2008 lëshuar në favorin e saj kishin mbetur pa u ekzekutuar. Ajo u mbështet në nenin 6 § 1 të Konventës dhe nenin 1 të protokollit nr. 1.

23. Gjykata vëren, dhe palët nuk e kundërshtuan, se vendimi 2006 ishte regjistruar në regjistrin e tokës më 3 shtator 2007, siç konfirmohej nga ZRPP-ja (shih paragrafët 6 dhe 12 më sipër). Megjithatë, vendimi i vitit 2006 nuk ishte i zbatueshme, për sa i përket pronësisë së plotë të tokës, duke qenë se ai vendim nuk përcaktonte kufijtë faktik të tokës. Kërkuësja ishte plotësisht në dijeni për zbatueshmërinë e kufizuar të vendimit të vitit 2006 të paktën që prej qershorit 2008 (shih paragrafin 7 më sipër). Gjithashtu, vendimi i vitit 2006 u pushua nga Gjykata e Apelit Gjyrokastër më 5 dhjetor 2022 (shih paragrafin 18 më sipër). Edhe pse pranë Gjykatës së Lartë është pezull një apelim, vendimi i gjykatës së apelit është ligjërish detyrues. Për këtë arsye, sipas ligjit të brendshëm, vendimi i vitit 2006 nuk është më në fuqi.

24. Në lidhje me vendimin e vitit 2008, Gjykata tashmë ka gjykuar në të shkuarën një se një vendim gjyqësor “njohja e një fakti juridik të dhënat dokumentare të të cilit janë zhdukur”, marrë në përputhje me nenin 388 të Kodit të Procedurës Civile, është e një natyre deklarative (shih *Bici kundër Shqipërisë*, nr. 5250/07, § 51, 3 dhjetor 2015). Gjithashtu, në mbështetje të nenit 193 § 2 të Kodit Civil, këto vendime nuk duhet të regjistrohen në regjistrin e tokës (shih paragrafin 13 më sipër). së fundi, vendimi i vitit 2008 ka të bëjë me një aspekt ndihmës të lëndës vendosur në vendimin e vitit 2006. Duke qenë se ky i fundit nuk është më detyrues ose i zbatueshëm sipas ligjit të brendshëm, ky vendim është në fuqi edhe për vendimin e vitit 2008.

25. Për këtë arsye, ankesa është e pazbatuar sipas interpretimit të nenit 35 § 3 të Konventës dhe duhet të rrëzohet sipas nenit 35 § 4 të Konventës.

##### **C. Pretendimi për shkelje të nenit 13 të Konventës**

26. Ankesa e kërkueses bërë sipas nenit 13 të Konventës me pretendimin për mungesën e një mjeti efektiv për paraqitjen e ankesave mbështetur në Konventë pranë autoriteteve të brendshme është e lidhur me ankesat e shqyrtuara më sipër dhe për këtë arsye duhet të shpallet qartazi e pabazuar sipas interpretimit të nenit 35 § 3 të Konventës dhe duhet të rrëzohet sipas nenit 35 § 4 të Konventës (shih *Ljubičić kundër Kroacisë* (vendim), nr. 17338/05, 10 maj 2007).

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime:

*Vendos* se trashëgimtarët e kërkueses, z. Michail Angelos Pappas dhe znj. Evrydiki Prapopoulou (Papa), kanë arsye për të ndjekur kërkesën në vend të kërkueses;

*E shpall* kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 14 nëntor 2024.

**Viktoria Maradudina**  
ZËVENDËSSEKRETARE E PËRKOHSHME

**Peeter Roosma**  
KRYETAR

